



Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo



Agjencia e Kosovës për Akreditim

Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency

Data: 08.08.2017

Ref.: 657/17

Në mbështetje të nenit 4, dhe 23, të Ligjit për Administratën Shtetërore të Republikës së Kosovës (nr.03/L-189, datë 16.09.2010), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës (Nr. 04/L-037, datë 29.08.2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.20/2016, datë 20.09.2016), Këshilli Shtetërorë i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 52-të, të mbajtur më 28 Korrik 2017, mori:

V E N D I M

- I. Refuzohet kërkesa nr.576/17, datë 21.07.2017 e BPrAL Kolegji Fama për rishqyrtim të vendimit të KSHC-së nr.553/17, datë 06.07.2017 si e pabazuar.
- II. Mbetet në fuqi vendimi i KSHC-së nr.553/17, datë 06.07.2017.
- III. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetimi

BPrAL Kolegji Fama me 21.07.2017 ka dorëzuar kërkesën për rishqyrtim të vendimit të KSHC-së nr. 590/17, datë 06.07.2017, me te cilin vendim BPrAL Kolegjit Fama i është caktuar kuota per regjistrim të studentëve si më poshtë: Stomatologji, Dr Dent (program i integruar), 300 ECTS, maksimumi 20 studentë për vit akademik; Laborant Dentar, BSc, 180 ECTS, maksimumi 20 studentë për vit akademik, dhe Laborant Mjekësor, BSc, 180 ECTS, maksimumi 20 studentë për vit akademik.


Pas shqyrtimit të dokumentacionit te dorëzuar nga BPrAL Kolegji Fama, KSHC ka konstatuar që institucioni në fjalë nuk ka sjellë asnjë dëshmi mbi bazën e të cilës do të mund të merrej parasysh për të ndryshuar vendimin e KSHC-së. KSHC konsideron se gjendja faktike në kohën e vlerësimit të aplikacionit të Kolegjit Fama është trajtuar me saktësi maksimale nga AKA.

Vendimi i KSHC-së është në përputhje të plotë me nenin 22, pika 2 e Udhëzimit Administrativ për Akreditim (UA nr.20/2016, datë 20.09.2016) ku thuhet: “Duke u bazuar në rekomandimet nga raporti i ekspertëve, KSHC do të vendos për akreditim ose mos akreditim”. Andaj, bazuar në dispozitat e cekura me lartë, KSHC në mbledhjen e mbajtur me 28 korrik 2017, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqes padi në Gjykatën Themelore në Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative. Afati për paraqitjen e padisë është 30 ditë nga momenti i pranimet të këtij vendimi përfundimtar.

Vendimi iu dërgohet:

- BPrAL Kolegji Fama;
- MASHT;
- Arkivit të AKA-së.


Prof. Asoc. Dr. Blerim Rexha
Kryetar i Këshillit Shtetëror të Cilësisë

